



### VENDIM

Nr.51 Datë 17.04.2015

### PËR

### LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “KOXHERI ENERGJI” SH.P.K NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KOXHERRAJ ” ME FUQI TË INSTALUAR 0,62 MW ME AFAT 30 VJEÇAR.

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”; 9 dhe 13 pikat 1, gërma “a”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 gërma “a”; 5 pika 1 gërma “a”; 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.04.2015, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “**KOXHERI ENERGJI**” sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike, te kësaj shoqërie, nga HEC “Koxherraaj ” me fuqi të instaluar 0,62 MW, për një afat 30 vjeçar.

#### **Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “**KOXHERI ENERGJI**” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Dokumentacioni i përgjithshëm i percaktuar ne: nenin 9, pikat 1 (formatin e aplikimit); Nenin 9, pikat 2 ( dokumentacionin juridik, administrativ dhe

pronësor); Nenin 9, pikat 3 (dokumentacioni financiar dhe fiskal ) është plotësuar ne menyre korrekte.

- Dokumentacioni teknik lidhur me tipin e licenses te percaktuara ne: Nenin 9, pika 4.1.1 (Te dhena specifike per HEC); Neni 9, pika 4.1.2 (Te dhena per bllokun e tranformimit dhe lidhjen me sistemin) ; Neni 9, pika 4.1.3 ( Dokumentacioni teknik dhe grafik) ; Neni 9, pika 4.1.4 (Dokumentacioni tekniko- ekonomik); Neni 9, pika 4.1.5 ( Leje nga institucione te tjera), eshte plotesuar ne menyre korrekte .

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të liçensojë shoqërinë “**KOXHERI ENERGI**” sh.p.k, në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga HEC “Koxherra” me fuqi të instaluar 0,62 MW,për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve te ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI i ERE-s**

**Petrit AHMETI**